



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK  
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT

Nr. 9704/11 Prot.

Tiranë, më 14.11.2018

**NJOFTIM**

**Drejtuar:** Autoriteteve kontraktore

Sikurse jeni në dijeni, Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") me Udhëzimin Nr. 11, datë 30.05.2018 ka miratuar disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", të ndryshuar.

Një nga ndryshimet e miratuara me këtë udhëzim është edhe nxjerrja e urdhrin të prokurimit pa përcaktuar fondin limit për objektin konkret që do të prokurohet, pasi operatorët ekonomikë duhet të ofertojnë realisht bazuar në të dhënat teknike sasiore që përcaktohen në të.

Kohët e fundit, APP ka kryer një verifikim të hedhjes së të dhënave për fondin limit, në Sistemin e Prokurimit Elektronik (në vijim "SPE"), në rastin e prokurimeve me vlerë të vogël, ku është konstatuar se, në këto procedura prokurimi, autoritetet kontraktore shënojnë fondin limit 0 (zero) ose 1 (një).

Mos hedhja e të dhënave për fondin limit ka ndodhur për shkak se, në shpalljen e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, autoritetet kontraktore i referohen ndryshimit të sipërcituar të Udhëzimit Nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", të ndryshuar, me të cilin tashmë parashikohet që të mos shënohet fondi limit në urdhrin e prokurimit dhe në Ftesën për Ofertë.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, në Manualin Teknik "Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronik", përcaktohet se: "*Në dritaren "Kohëzgjatje dhe Vlera e parashikuar" që shfaqet, duhet të plotësoni fondin limit në fushën "Vlera e përafërt (LEK)" si dhe fushën "Kohëzgjatja e kontratës"*.

Në këtë kuptim, gjatë krijimit të dosjes së tenderit për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël në sistem, autoritetet kontraktore **duhet të hedhin fondin limit të parashikuar**, dhe jo ta shënojnë atë me vlerë 0 (zero), pasi SPE është programuar për të mos e shfaqur fondin limit tek operatorët ekonomikë.

Pavarësisht se, SPE është programuar për të mos identifikuar fondin limit, hedhja e tij në sistem nga autoritetet kontraktore është e nevojshme për gjurmueshmërinë e të gjithë procesit të prokurimit, për kryerjen e përlogaritjeve statistikore në lidhje me kursimin e përfituar, evidentimin e shpenzimeve të kryera nga autoritetet kontraktore, analizimin e rasteve të anulimit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, si dhe analizimin e efijencës së këtyre procedurave, në të cilat nuk përcaktohet fondi limit për objektin konkret të prokurimit.

DREJTOR I PËRGJITHSIËM

Reida Kashta



Konc: D. Elezi

Pranoi: G. Pagria

Miratoi: A. Dimo